



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 88, dt. 13.04.2016**

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e dates 13.04.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit të ndërtimit të Hec-Osojë, Qarku Korçë, kërkesë e shoqërisë, “Favina” sh.p.k.
2. Shoqëria të kontribuojë për restaurimin e një objekti monument kulture në Voskopojë, sipas një projekt-preventivi të propozuar nga DRKK Korçë.
3. Ngarkohet DRKK Korçë për korrespondencën në vazhdim me shoqërinë dhe vënien në dijeni të Këshillit Kombëtar të Restaurimit për zbatimin e pikës 2 të këtij vendimi.
4. Gjatë procesit të zbatimit, të projektit për ndërtimin e Hec- Osojë, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**



**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**